

VENDIM
Nr. 23/2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 71/2020,
“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, PËR ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE HARTIMIN
E NJË RAPORTI PËRMBLEDHËS DHE INFORMUES, PËR GJETJET DHE
KONKLuzionET QË KANË NXJERRË VERIFIKIMET E KRYERA NGA
INSTITUCIONET PËRKATËSE NË SHQIPËRI, PËR ÇËSHTJET E RAPORTIT
TË ANËTARIT TË ASAMBLESE PARLAMENTARE TË KËSHILLIT TË
EVROPËS, DICK MARTY, PËR BASHKËPUNIMIN DHE ROLIN PËR TË CILIN
PRETENDOHET SE KANË LUAJTUR PËRFAQËSUES POLITIKË SHQIPTARË
OSE INSTITUCIONE PUBLIKE SHQIPTARE, NËPËRMJET VEPRIMEVE
DHE MOSVEPRIMEVE, NË NDIHMË TË SË ASHTUQUAJTURËS VEPRIMTARI
KRIMINALE E DREJTUESVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës; të nenit 24, pika 3/1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, me kërkesë të Komisionit të Posaçëm,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm për administrimin e dokumentacionit dhe hartimin e një raporti përmbledhës dhe informues, për gjetjet dhe konkluzionet që kanë nxjerrë verifikimet e kryera nga institucionet përkatëse në Shqipëri, për çështjet e raportit të anëtarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dick Marty, për bashkëpunimin dhe rolin për të cilin pretendohet se kanë luajtur përfaqësues politikë shqiptarë ose institucione publike shqiptare, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, në ndihmë të së ashtuquajturës veprimtari kriminale e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 71/2020, zgjatet për një periudhë 3-mujore nga data e përfundimit të këtij afati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 22.2.2021.